



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 43, datë 23.09.2016

PËR LICENCIM SH. A UJËSJELLËS URA VAJGURORE

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" si dhe VKM nr. 958, date 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" Komisioni Kombëtar Rregullator,

V E N D O S I:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit, operatorit Sh.a Ujësjiellës Ura Vajguore me:
Drejtues Ligjor Petref Sula
Drejtues Teknik Jolanda Gjordeni
2. Operatori Sh.a Ujësjiellës Ura Vajguore autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia: Ura Vajguore
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.83, datë 17.12.2018

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 43, DATË 23.09.2016, "PËR LICENCIMIN E SH.A. UJËSJELLËS
URA VAJGURORE"**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 17.12.2018 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës Ura Vajgurore sh. a për ndryshimi të licencës për shkak të shtimit të kategorisë së shërbimit të largimit të ujërave të ndotura.

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Ura Vajgurore (**U Ura Vajgurore**) me shkresën nr. 432 prot. datë 05.10.2018, ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) për shkak të shtimit të kategorisë së shërbimit për largimin e ujërave të ndotura kategorinë C, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për rinovim licence për efekt të shtimit të kategorisë për largimin e ujërave të ndotura U Ura Vajgurore në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 63 date 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (**VKM nr. 63**).
3. Ujësjiellës Ura Vajgurore ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar për efekt të shtimit të kategorisë së shërbimit për largimin e ujërave të ndotura dhe ndryshimit të emrit të shoqërisë me dokumentacionin si më poshtë:

- Me vendim të Këshillit Bashkiak Ura Vajgurore nr. 72 datë 26.12.2017 miratoi transferimin e shërbimit të kanalizimeve të ujërave të ndotura në ndërmarrjen Ujësjiellës Ura Vajgurore Sh.a me të gjitha të drejtat dhe detyrimet;
- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 01 datë 22.02.2018 miratoi raportin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë ujësjiellës kanalizime sh.a Ura Vajgurore.
- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Ura Vajgurore nr. 03.prot. date 25.06.2018, “Mbi ndryshimin e emërimit të shoqërisë Ujësjiellës Ura Vajgurore.

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) ERRU ka licencuar shoqërinë Ujësjiellës Ura Vajgurore me vendim nr. 43, datë 23.09.2016 "Për licencim sh. a Ujësjiellës Ura Vajgurore", me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik;
- b) Shoqëria UK Ura Vajgurore ka marrë në administrim sistemin e kanalizimeve nga Bashkia Ura Vajgurore dhe do të ofrojë shërbimin e largimit të ujërave të ndotura për 19 907 banorë në Bashkinë Ura Vajgurore;
- c) Shoqëria ka ndryshuar emrin nga shoqëria “Ujësjiellës Ura Vajgurore” sh.a në shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Ura Vajgurore” sh.a.

5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për shtimin e kategorisë së shërbimit për largimin e ujërave të ndotura ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Ujësjiellës Ura Vajgurore sh.a të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë të garantojë që të licencuarit të veprojnë në përputhje me kushtet e licencës së tyre dhe të mbrojnë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;
- c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e Konsumatorëve” të ndryshuar (ligji nr. 9902);
- d) Kërkesave të VKM nr. 63, veçanërisht në lidhje me organizimin e njësive të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve si shoqëri aksionare sipas sistemit me një nivel administrimi dhe funksionimit në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

6. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë Ujësjiellës Ura Vajgurore, rekomandon:

- Shoqëria UK Ura Vajgurore duhet të aplikojë pranë ERRU për miratimin e tarifave për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e Ujësjiellës Ura Vajgurore është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

- I. Titulli i vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr.43, datë 23.09.2016 "Për licencim sh.a Ujësjetllës Ura Vajgurore", ndryshon si më poshtë:

“Për licencimin e Ujësjetllës Kanalizime Ura Vajgurore sh.a. “

- II. Kudo në vendimin nr.43, datë 23.09.2016 "Për licencim sh.a Ujësjetllës Ura Vajgurore", togfjalëshi *“Sh.a Ujësjetllës Ura Vajgurore”* ndryshohet si më poshtë:

“Ujësjetllës Kanalizime Ura Vajgurore sh.a.”

- III. Në pikën 2 të vendimit shtohet kategoria si më poshtë:

“Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI